



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 86-të të mbajtur më 05.05.2023, miratoi sa vijon.

VENDIM

Denoncimi I regjistruar me numër 12-964/1 të datës 01.03.2021, kundër drejtoreshës së Kopshtit të fëmijëve /// – ///, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Lënda me numër 12-964/1 të datës 01.03.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi të publikohet në formë të depersonalizuar në ven faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur më datë 01.03.2021 është dorëzuar denoncim kundër drejtoreshës së kopshtit të fëmijëve /// – /// dhe është formuar lëndë me numër 12-964/1 të datës 01.03.2021.

Në denoncim, parashtruesi thekson pohime për shpenzime të pakujdesshme të mjeteve nga buxheti për shkak të punës së pakujdesshme të drejtoreshës së kopshtit /// nga ///, e cila sipas asaj që u prezantua, punësoi dy persona në pozitat kujdestare dhe edukatore. Sipas parashtruesit gjatë pandemisë, në momentin e caktuar nuk ka pasur nevojë për një punësim të tillë të personave në këto pozita dhe shpenzime të mjeteve buxhetore.

Parashtruesi i denoncimit kërkon nga KSHPK-ja të ndërmarr masa kundër personit të përmendur në denoncim

Pas shqyrtimit të pretendime të bëra në denoncim, KSHPK-ja konstatoi se veprimet e denoncuar nuk janë korrupsion në pajtim me definicionin e përcaktuar në Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin e lëndës.

Duke pasur parasysh sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përpiloi: A.R.M.

Miratoi: G.T., anëtar i KSHPK-së

**КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ**
Kryetar
Biljana Ivanovska

